

Aida Veizaj pritet të emërohet drejtore e Byrosë Kombëtare të Hetimit

Komisioni i Përzgjedhjes ka konkluduar si kandidaten më të mirë për të udhëhequr Byronë Kombëtare të Hetimit për 5 vitet e ardhshme, zv.Drejtoreshën e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Aida Veizaj.

Autor: [Edmond Hoxhaj](#) | BIRN | Tiranë



Zëvendeshja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Aida Veizaj, | Foto : LSA

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, SPAK, njoftoi të hënën se për pozicionin e drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit i është rekomanduar Këshilli të Lartë të Prokurorisë, KLP emërimi i kandidatës Aida Veizaj, aktualisht zv/Drejtoreshë e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Në njoftimin e SPAK thuhet se Komisioni i Përzgjedhjes së Drejtorit të BKH-së ka përfunduar procesin e identifikimit të kandidatit më të mirë për këtë pozicion.

“Komisioni i Përzgjedhjes zhvilloi dy mbledhje në datat 24.07.2020 dhe 27.07.2020, në prani dhe të Komisionit të Pavarur të Rishikimit, i përbërë nga dy përfaqësues të Bashkimit Europian dhe dy përfaqësues të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri”, citohet në njoftim.

Më tej shpjegohet se pasi shqyrtimit të dokumentacionit të katër kandidatëve që kishin ngelur në garë: Artur Beu, Ervin Hodaj, Idajet Faskaj dhe Aida Veizaj, Komisioni vendosi që t'i rekomandojë KLP-së, emërimin Aida Veizaj në pozicionin Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, për një mandat pesëvjeçar.



RRETH AUTORIT

Edmond Hoxhaj

Edmond Hoxhaj është gazetar i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri. Ai ka punuar më herët për gazetën “Shqip”. Ai ka përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës në degën Gjuhë-Letërsi. Hoxhaj ka punuar që nga viti 2001 në disa media të shkruara, ku ka mbuluar çështjet e aktualitetit dhe të drejtësisë.